



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 19.03.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.03.2022 të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik “Eko term” Shpk & “Arkis” Shpk- Suhareke**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rregullimi I varrezave dhe hapsirave ne Komunen e Prishtinës , me Nr. të Prok: 616-21-8348-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 034/1 521** nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim si e bazuar e **Grupit te Operatorëve Ekonomik “Eko term” Shpk & “Arkis” Shpk- Suhareke** të dt. 16.03.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rregullimi I varrezave dhe hapsirave ne Komunen e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-21-8348-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 034/1 521**, kundër *Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues*, të datës 11/05/2022.

1. Vërtetohet Kërkesa për Rishqyrtim e datës 16.03.2022 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *ta kthej ne rivleresim aktivitetin e prokurimit Rregullimi I varrezave dhe hapsirave ne Komunen e Prishtinës - per loton 1* , me Nr. të Prok: **616-21-8348-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 34/1 521**, sipas Kërkeses për rishqyrtim të datës 16.03.2022
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grupit te Operatorëve Ekonomik “Eko term” Shpk & “Arkis” Shpk- Suhareke me datë 16.03.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rregullimi I varrezave dhe hapsirave ne Komunen e Prishtines”,** me Nr. të Prok: **616-21-8348-5-2-1** dhe numër te brendshëm 616 21 034/1 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 19.03.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar se pretendimet e OE jane te bazuara andaj dhe mori vendim qe aktivitetin per Rregullimin e varrezave dhe hapsirave ne Komunen e Prishtines per Loton 1, me numer te prokurimit 616-21-8348-5-2-1 dhe numer te brendshem 616 21 034/1 521 ta kthej ne rivleresim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit